

**GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË**

KA Nr. 504/2010  
24 Janar 2011

Gjyqtari konfirmues, Dr. Horst Proetel, Gjyqtar i EULEX-it në Gjykatën e Qarkut, në lëndën penale kundër të pandehurve:

**Xheme Thaqi**, emri i babait Hamit, lindur me 20 korrik 1975 në fshatin Caprac, komuna e Prizrenit, ku edhe banon aktualisht, Shqiptar Kosovar, në paraburgim prej datës 27 maj 2010,

**Abdyl KUKAJ**, emri i babait Hasan, lindur me 8 nëntor 1983 në fshatin Korish, Prizren, me vendbanim në fshatin Korish, Prizren, Shqiptar Kosovar, në paraburgim prej vitit 2010,

**Gezim Iseberi**, emri i babait Qemajl, lindur me datë 5 nëntor 1968 në Kukes, Republika e Shqipërisë, me vendbanim në fshatin Kodërlum, komuna e Shtimes, Republika e Shqipërisë, qytetar shqiptar, gjendje ekonomike të varfër, në paraburgim prej datës 4 dhjetor 2010,

I akuzuar me aktakuzën e ngritur në Gjykatë me datë 23 dhjetor 2010, nga Prokurori i EULEX-it nga Zyra e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), Maarit Loimukoski, për veprat penale në vijim:

**Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e substancave narkotike dhe substancave psikotropike**, në pajtim me nenin 229, paragrafi 1, 2, 3, dhe 4 I Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe që ndëshkohet me nga tre deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim;

**Krim i Organizuar**, sipas nenit 274 të KPK dhe që ndëshkohet me nga shtatë deri në njëzet vjet burgim;

Në pajtim me nenin 316 (4) të Kodit të Procedurës Penale (KPPK) nxjerr si në vijim:

**AKTVENDIM**

**Aktakuza e ngritur në Gjykatë me datë 23 dhjetor 2011 konfirmohet për të gjitha pikat e akuzës dhe të pandehurit.**

## **ARSYETIMI**

### **Tërheqje e aktakuzës**

Nuk është parashtruar në Gjykatë asnjë tërheqje me shkrim dhe seanca për konfirmim është mbajtur siç ishte parashikuar, në prani të të gjitha palëve.

### **Parashtrësit e palëve**

Pas leximit të aktakuzës, të gjithë të pandehurit u deklaruan të pafajshëm.

Zyra e Prokurorit u ka siguruar avokatëve mbrojtës të gjitha materialet e renditura në nenin 307 të Kodit të Procedurës, kryesisht provat në të cilat bazohet aktakuza.

Megjithëse avokati mbrojtës i të pandehurit Gezim Iseberi, Z. Gafurr Elshani, u ankua lidhur me mungesën e sistematizimit të provave të siguruara, ai nuk kërkoi shtyrjen e seancës për konfirmim për tu përgatitur më mirë. Gjithë të pandehurit dhe avokatët e tyre shprehën dëshirën për të vazhduar për të mos humbur kohë. Mangësitë në provat e dorëzuara nuk janë serioze dhe në këtë mënyrë nuk është dëmtuar e drejta për një mbrojtje të drejtë.

Avokatët mbrojtës në deklaratat e tyre kanë theksuar faktin se aktakuza nuk i propozon Gjykatës prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se janë kryer veprat penale të pretenduara. Ata theksojnë faktin se aktakuza nuk paraqet prova të qarta lidhur me faktin se kur, si, dhe ku, sepse të pandehurit akuzohen për, posedim, shpërndarje, shitje e paautorizuar e substancave narkotike që pretendohet të ketë ndodhur gjatë një periudhe të gjatë kohore. Për këtë arsye, Prokurori është i detyruar, sipas mbrojtjes, të spjegojë në detaje gjithë periudhën kohore, rrugët dhe mjetet e përdorura dhe destinacionin përfundimtar. Në mungesë të gjithë këtyre elementeve, mbrojtja argumenton se kërkesat/kushtet për konfirmimin e aktakuzës nuk janë plotësuar.

### **Kompetenca e Gjykatës dhe historiku procedural**

Gjykata është kompetente për të vendosur lidhur me konfirmimin e aktakuzës së ngritur nga Zyra e Prokurorit Special sipas Ligjit mbi Juridiksionit të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe vendimit të Zëvendës Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, datë 4.1.2011 lidhur me sistemin e brendshëm për caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Seanca për konfirmim është caktuar për ditën e hënë me datë, 24.01.2011, pasi që gjyqtari ka vlerësuar se aktakuza është përpiluar në pajtim me nenin 305 të Kodit të Procedurës. Të gjitha kushtet e renditura janë plotësuar.

Aktakuza është dorëzuar në kohë duke iu dhënë mundësinë të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës që të përgatiten për seancë.

## Gjetjet e Gjykatës

Në analizën e dosjes së Gjykatës dhe aktakuzës, Gjyqtari konfirmues ka detyrimet ndaluese të parapara nga neni 317 paragrafi 1 i KPPK, që do të thotë se rezultati i këtij aktvendimi nuk mund të paragjykojë në asnjë mënyrë rezultatin e shqyrtimit kryesor.

Aktakuza dhe lënda në tërësi nuk përmbajnë prova të papranueshme. Nuk ka tregues që deklaratat e të pandehurve dhe ato të dëshmitarëve janë siguruar me mjete të padrejta në kuptim të nenit 155 të KPPK.

Përsa u përket raporteve të përgjimit ato janë bërë në mënyrë të ligjshme bazuar në vendimet e gjyqtarit paraprak në pajtim me nenin 256 të KPPK.

Mbrojtja nuk ka dyshime lidhur me ligjshmërinë e masave të fshehta të hetimit dhe të vëzhgimit. Masat ishin të nevojshme dhe zbatimi ka qenë në pajtim me ligjin.

Nëse raportet mbi përgjimet e ndryshme dhe provat e tjera të siguruara janë të mjaftueshme për të sjellë deri tek dënimi, kjo nuk ka të bëjë me pranueshmërinë e provave por me bazat e tyre.

Nuk është kompetencë e Gjyqtarit konfirmues që të vlerësojë në mënyrë definitive nëse provat e paraqitura janë të mjaftueshme për të sjellur deri tek dënimi i të pandehurve. Kjo mund të bëhet vetëm në shqyrtimin kryesor me vlerësimin nga trupi gjykues duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe provat përfshirë përshtypjen personale për të pandehurit, dëshmitarët dhe provat e tjera të siguruara nga Prokurori dhe të nxjerra ex officio.

Gjyqtari konfirmues ka për detyrë vetëm të sigurojë se formalitetet e aktakuzës janë plotësuar dhe provat e pranueshme justifikojnë supozimin se ka gjasa të vërteta për dënim. Marrja e provave gjatë seancës për konfirmim përjashtohet në mënyrë të qartë nga neni 314, paragrafi 6 i KPPK.

Përkundër mendimit ligjor të avokatëve mbrojtës dhe të pandehurve, gjyqtari konfirmues nuk mund të ndalojë procedurën për shkak të dyshimeve lidhur me kryrjen e veprave penale nga klientët e tyre, respektivisht nga vetë ata.

Sipas vlerësimit të fakteve dhe provave të pranishme, ekziston dyshimi i arsyeshëm se gjithë të pandehurit kanë kryer veprat penale në fjalë sipas nenit 229, 274, 23 të KPK-së.

Masat e vëzhgimit, deklaratat e të pandehurve dhe dëshmitarët e dëgjuar tregojnë masivisht se të paktën të pandehurit **Kukaj** dhe **Thaqi** kanë bashkëpunuar dhe janë marrë me substanca narkotike sipas nenit 229, paragrafi 1, 2, 3 dhe paragrafi 4, pika 1 mes datës 24 korrik dhe 15 shtator 2009 për të cilat janë akuzuar (akuza 1) dhe se ata janë pjesë e një grupi të organizuar edhe të dyshuar të tjerë si vëllai i Xheme Thaqit, Qerim Thaqi. Për këtë arsye pika 3 dhe 4 e aktakuzës duket të jetë e justifikuar. Ata kanë bërë këtë në bashkëkryerje sipas nenit 229, paragrafi 1,2, 3 dhe 4 KPK duke organizuar

dhe shitur substanca narkotike që transportoheshin nga Shqipëria, përmes territorit të Kosovës, në vendet e Evropës perëndimore në periudhën kohore mes korrikut të vitit 2009 dhe maj 2010 (pika 3 dhe 4). Siç deklarohet në aktakuzë, Xheme Thaqi duket të jetë njeriu më i besueshëm i atij që besohet të jetë udhëheqësi i grupit të organizuar në Kosovë i përfshirë në organizatë, kryesisht koordinimi i aktiviteteve të grupit. Abdyl Kukaj supozohet të jetë anëtar i kyç i grupit që vepron në disa vende të Evropës. Aktakuza spjegohet vetë. Nuk ka nevojë që të përsëritet e gjitha. Përfshirja e Kukaj dhe Thaqit në grupin kriminal dhe aktivitetet e tyre si dërgimi i drogës, në veçanti në shtator dhe nëntor të vitit 2009 mund të kuptohet nga përgjimi i telefonatave dhe mesazheve të renditura në pikat 1- 38 të aktakuzës (faqet 16- 25) lidhur me dërgesën e përmendur dhe pika 1- 21 në faqet 33 deri 36. Arsyetimi i aktakuzës është bindës dhe verteton të paktën dyshimin e arsyeshëm se të dy kanë kryer krimet e pretenduara. Kjo mbështetet nga dosjet që përfshijnë raportet e policisë të vëzhgimit visual në vende publike me anë të CD shtesë dhe informatave të marra nga ndihma ligjore ndërkombëtare nga Sllovenia dhe Italia. Edhe tregues të tjerë lidhur me kryerjen e veprave penale nga të akuzuarit Kukaj dhe Thaci mund të bazohen – siç përmban aktakuza – në rezultatet e hetimit financiar; përgjimet e telekomunikimit, bastisje shtëpish dhe raporte të policisë siç janë përmbledhur në në faqet 37- 42 të aktakuzës. Aktvendimi i referohet provave të përmendura të cilat do të jetë e nevojshme të interpretohen në shqyrtimin kryesor bazuar në të gjitha provat direkte dhe indirekte, përshtypjet personale për të pandehurit, dëshmitarët dhe deklaratat e tyre.

Gjyqtari konfirmues nuk ndjek mendimin ligjor të mbrojtjes për të hedhur aktakuzën për shkak të mungesës së fakteve lidhur me modalitetet e blerjes së substancave narkotike, rrugët e përdorura, sasia e substancave narkotike të shitura dhe destinacioni i tyre. Telefonatat e përgjuara përmbajnë të paktën informata lidhur me destinacionet (Hollandë dhe Zvicër) dhe shifrat mbi mallin e porositur ( 105 kg). Këto mund të konkretizohen më tej gjatë shqyrtimit kryesor.

Aktakuza duhet të konfirmohet gjithashtu lidhur me të pandehurin Gezim Iseberi i akuzuar për, posedim dhe shpërndarje e paautorizuar e substancave të rrezikshme narkotike dhe substancave psikotropike sipas nenit 229, paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 i Kodit Penal të Kosovës, të kryera në bashkëkryerje sipas nenit 23, 25 i Kodit (pika 2) dhe për anëtarësi në një organizatë (grup) që ka për qëllim kryerjen e veprave penale të rënda në kuptim të nenit 274, paragrafi 12 i KPK-së.

Është e vërtetë se aktakuza ngarkon Iseberin vetëm për kryerjen e veprës penale të, posedim dhe shpërndarje e paautorizuar i substancave të rrezikshme narkotike, duke vepruar mes datës 4 dhe 6 shtator 2009 dhe në veturën e tij të ndaluar nga policia nuk është gjetur drogë. Por, përkundër argumentimit të avokatit të tij mbrojtës kjo nuk do të thotë se nuk ka gjasa të mjaftueshme që ai të dënohet. E njëjta gjë vlen për akuzën; pjesë e një grupi kriminal (pika 5). Deklarata e Iseberit, e konfirmuar nga të pandehurit e tjerë, se ai nuk njeh të pandehurit e tjerë, Kukaj dhe Thaqi, është natyrisht e gabuar. Raporti i vëzhgimit lidhur me aktivitetet e tija demonstroi se Iseberi ka pasur të paktën një takim me Thaqin me datë 5 shtator. Kjo jep prova të mjaftueshme lidhur me përfshirjen e tij në përgatitjen e dërgesave në shtator të vitit 2009 dhe tregon se ai nuk është plotësisht i besueshëm. Raportet e vëzhgimit demonstrojnë se i pandehuri Iseberi ka qenë shoferi i

një furgoni me numër regjistrimi KU 1962 me datë 5, që kishte përdorur ditën përpara. Ai tregoi një sjellje të dyshimtë duke zëvendësuar targat origjinale. Një veprim tjetër i rëndë i dyshimtë ka qenë se, ndërsa ai ndiqej nga një makinë e policisë, ai ka hedhur një paketë e cila me shumë gjasa përmbante drogë që ai transportonte. Edhe pse nuk ka prova të sakta se pakoja përmbante substanca narkotike, kjo tregohet nga fakti se Iseberi ka takuar të pandehurin Thaqi ditën përpara rrugëtimit të tij dhe natyrisht pakoja është marrë nga anëtarë të grupit kriminal dhe është dërguar në Evropë si substanca narkotike. Kjo nxjerr në dritë shumë gjëra dhe njollos rëndë personalitetin e të pandehurit i cili deklaroi se është i pafajshëm.

E njëjta gjë vlen edhe për akuzën si pjesë e grupit kriminal dhe duke vepruar në bashkëkryerje me të pandehurit e tjerë. Aktakuza me të cilën ka të bëjë ky aktgjykim, flet me gjuhë bindëse.

Meqënëse akuzat janë të rënda dhe justifikojnë dënim të lartë, paraburgimi deri tani është në proporcion të duhur. Gjykata kompetente për shqyrtimin kryesor duhet të vendosë lidhur me paraburgimin e tre të pandehurve.

Dr. Horst Proetel  
Gjyqtari konfirmues i EULEX-it

## Mjet Ligjor

Aktvendimi për konfirmim të aktakuzës është i formës së prerë. Neni 317, paragrafi 2 i KPPK si “lex specialis” për dispozitat e përgjithshme për ankesa (neni 431, paragrafi 1) lejon ankesë vetëm nga prokurori dhe pala e dëmtuar në rast të hudhjes së aktakuzës.